



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR

Tiranë, më datë 01.03.2023

KOMUNIKIM PËR MEDIAN

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Florjan Kalaja (kryesues), Igerta Hysi (anëtare) dhe Dhimitër Lara (anëtar), sot më datë 01.03.2023, shalli vendimin lidhur me çështjen e regjistruar me nr. 21/82 akti, datë 07.12.2022, mbi ankimin e paraqitur nga ankuesit/të pandehurit F.T. G.N., F.P., M.Gj., G.Ç., A.M., L.S., B.M., V.Zh., Xh.H., B.T., I.L., L.A., I.B., si dhe ankimin e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kundër vendimit nr. 47, datë 29.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që ka vendosur:

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me **vendimin nr. 47, datë 29.07.2022**, ka vendosur:

1. “Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit F.T. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal pasi nuk provohet se e ka kryer këtë vepër penale.

1.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit F.T. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shpërdorimit të karburantit) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

1.2. Deklarimin fajtor të të pandehurit F.T. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i ndërtimeve pa leje) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

1.3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri F.T. dënohet me një dënim të vetëm prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

1.4. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit F.T. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

1.5. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri F.T. në një burg të sigurisë së zakonshme.

1.6. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit F.T. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit F.P. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

2.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit F.P. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shpërdorimit të karburantit) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

2.2. Deklarimin fajtor të të pandehurit F.P. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

2.3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri F.P. dënohet me një dënim të vetëm prej 3 (tre) vjet burgim.

2.4. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit F.P. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim.

2.5. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri F.P. në një burg të sigurisë së zakonshme.

2.6. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit F.P. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit G.N. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

3.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit G.N. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

3.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri G.N. dënohet me një dënim të vetëm prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

3.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit G.N. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj burgim.

3.4. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri G.N. në një burg të sigurisë së zakonshme.

3.5. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit G.N. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

4. Deklarimin fajtor të të pandehurit L.S. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande

publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

4.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit L.S. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

4.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri L.S. dënohet me një dënim të vetëm prej 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj burgim.

4.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit L.S. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

4.4. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri L.S. në një burg të sigurisë së zakonshme.

4.5. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit L.S. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

5. Deklarimin fajtor të të pandehurës B.T. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

5.1. Deklarimin fajtor të të pandehurës B.T. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

5.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve e pandehura B.T. dënohet me një dënim të vetëm prej 2 (dy) vjet burgim.

5.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës B.T. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.

5.4. Vuajta e dënimit të kryhet nga e pandehura B.T. në një burg të sigurisë së zakonshme.

5.5. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurës B.T. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

6. Deklarimin fajtor të të pandehurit B.M. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

6.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit B.M. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

6.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri B.M. dënohet me një dënim të vetëm prej 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj burgim.

6.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit B.M. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

6.4. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri B.M. në një burg të sigurisë së zakonshme.

6.5. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit B.M. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

7. Deklarimin fajtor të të pandehurës I.B. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

7.1. Deklarimin fajtor të të pandehurës I.B. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim.

7.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve e pandehura I.B. dënohet me një dënim të vetëm prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

7.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës I.B. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit burgim.

7.4. Vuajta e dënimit të kryhet nga e pandehura I.B. në një burg të sigurisë së zakonshme.

7.5. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurës I.B. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

8. Deklarimin fajtor të të pandehurit G.Ç. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

8.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit G.Ç. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit 6(gjashtë) muaj burgim.

8.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri G.Ç. dënohet me një dënim të vetëm prej 2 (dy) muaj e 6 (gjashtë) muaj burgim.

8.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit G.Ç. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj burgim.

8.4. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri G.Ç. në një burg të sigurisë së zakonshme.

8.5. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit G.Ç. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

9. Deklarimin fajtor të të pandehurës M.Gj. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit 6(gjashtë) muaj burgim.

9.1. Deklarimin fajtor të të pandehurës M.Gj. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit 6(gjashtë) muaj burgim.

9.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve e pandehura M.Gj. dënohet me një dënim të vetëm prej 2 (dy) vjet burgim.

9.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës M.Gj. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.

9.4. Vuajta e dënimit të kryhet nga e pandehura M.Gj. në një burg të sigurisë së zakonshme.

9.5. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurës M.Gj. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

10. Deklarimin fajtor të të pandehurit Xh.H. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit 6(gjashtë) muaj burgim.

10.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Xh.H. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit 6(gjashtë) muaj burgim.

10.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri Xh.H. dënohet me një dënim të vetëm prej 2 (dy) vjet burgim.

10.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Xh.H. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.

10.4. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri Xh.H. në një burg të sigurisë së zakonshme.

10.5. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit Xh.H. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

11. Deklarimin fajtor të të pandehurit A.M. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit 6(gjashtë) muaj burgim.

11.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit A.M. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit 6(gjashtë) muaj burgim.

11.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri A.M. dënohet me një dënim të vetëm prej 2 (dy) vjet burgim.

11.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit A.M. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.

11.4. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri A.M. në një burg të sigurisë së zakonshme.

11.5. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit A.M. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

12. Deklarimin fajtor të të pandehurit B.M. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit 6(gjashtë) muaj burgim.

12.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit B.M. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit 6(gjashtë) muaj burgim.

12.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri B.M. dënohet me një dënim të vetëm prej 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj burgim.

12.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit B.M. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

12.4. Në aplikim të neneve 261 pika 1, gërma “c” të K.Pr.Penale, duke qenë se koha e paraburgimit është më e madhe se masa e dënimit të caktuar urdhërohet shuarja e masës së sigurimit “Arrest në burg”, caktuar ndaj të pandehurit B.M. me vendimin Nr. 50, datë 05.07.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

12.5. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit B.M., nga ambientet e paraburgimit nëse nuk mbahet apo nëse nuk duhet të mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.

12.6. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit B.M. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.

13. Deklarimin fajtor të të pandehurës A.S. për kryerjen e veprës penale të “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit e 3 (tre) muaj burgim.

13.1. Deklarimin fajtor të të pandehurës A.S. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me me 1 (një) vit e 3 (tre) muaj burgim.

13.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve e pandehura A.S. dënohet me një dënim të vetëm prej 1 (një) vit e 9 (nëntë) muaj burgim.

13.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës A.S. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 2 (dy) muaj burgim.

13.4. Vuajta e dënimit të kryhet nga e pandehura A.S. në një burg të sigurisë së zakonshme.

13.5. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit A.S. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh

14. Deklarimin fajtor të të pandehurës L.A. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, (episodi i shkeljeve në tre tendera) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim.

14.1. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës L.A. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 8 (tetë) muaj burgim.

14.2. Vuajta e dënimit të kryhet nga e pandehura L.A. në një burg të sigurisë së zakonshme.

15. Deklarimin fajtor të të pandehurës V.Zh. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim.

15.1. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës V.Zh. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 8 (tetë) muaj burgim.

15.2. Vuajta e dënimit të kryhet nga e pandehura V.Zh. në një burg të sigurisë së zakonshme.

15.3. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit V.Zh. i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh

16. Deklarimin fajtor të të pandehurit I.L. për kryerjen e veprës penale të “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

16.1. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit I.L. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj burgim.

16.2. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri I.L. në një burg të sigurisë së zakonshme.

17. Deklarimin fajtor të të pandehurës Gj.M. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim.

17.1. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Gj.M. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 8 (tetë) muaj burgim.

17.2. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë në provë të pandehurin Gj.M. për një periudhë prove prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale. Gjatë kësaj kohe i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

18. Deklarimin fajtor të të pandehurit I.B. për kryerjen e veprës penale të “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.

18.1. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit I.B. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 8 (tetë) muaj burgim.

18.2. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë në provë të pandehurin I.B. për një periudhë prove prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale. Gjatë kësaj kohe i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

19. Deklarimin fajtor të të pandehurit P.Gj. për kryerjen e veprës penale të “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

19.1. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit P.Gj. i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim.

19.2. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë në provë të pandehurin P.Gj. për një periudhë prove prej 4 (katër) vjetësh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale. Gjatë kësaj kohe i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi...”

...Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 469, datë 31.10.2022, ka vendosur:

“1. Ndrejën e gabimit material në pikën 15-të të dispozitivit të vendimit nr. 47, datë 29.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duhet korrigjuar shprehjen “Shpërdorim i detyrës” e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal” me shprehjen “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 të Kodit Penal.

2. Ky vendim bëhet pjesë integrale e vendimit të ndrequr, konkretisht vendimit nr. 47, datë 29.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”

Në përfundim, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vendosi:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 47, datë 29.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 47, datë 29.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin e Krimin e Organizuar me ndryshimet si më poshtë vijon:
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit z. F.T. për kryerjen e veprës penale “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” e kryer në bashkëpunim, sipas nenit 258 dhe 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim.
3. Në bazë dhe për zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, pas bashkimit të dënimeve, caktimin si një dënim të vetëm për të pandehurin z. F.T. të masës 5 vjet burgim.
4. Në bazë dhe për zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, pas zbritjes me 1/3 e dënimit, caktimin si dënim përfundimtar ndaj të pandehurit z. Fatos Tushe të masës 3 vjet dhe 4 muaj burgim.
5. Në bazë dhe për zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurës znj. B.T. në provë për një periudhë të barabartë me dyfishin e kohës së mbetur të pavuajtur nga dënimi përfundimtar me burgim, me kushtin që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.
6. Detyrimin e të pandehurës znj. B.T. të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës.
7. Në bazë dhe për zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit z. B.M. në provë për një periudhë 3 vjet, me kushtin që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.
8. Detyrimin e të pandehurit z. B.M. të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës.
9. Në bazë dhe për zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurës znj. L.A. në provë për një periudhë 1 vit dhe 4 muaj, me kushtin që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.
10. Detyrimin e të pandehurës znj. L.A. të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës.

11. Në bazë dhe për zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurës znj. I.B. në provë për një periudhë 2 vjet, me kushtin që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale.
12. Detyrimin e të pandehurës znj. I.B. të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës.
13. Në bazë dhe për zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurës znj. V.Zh. në provë për një periudhë 1 vit dhe 4 muaj, me kushtin që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale.
14. Detyrimin e të pandehurës znj. V.Zh. të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës.
15. Shumat monetare të sekuestruara të pandehurve z. F.P., z. G.N., z. F.T. dhe z. I.L.të konfiskohen dhe të kalohen në favor të shtetit, sipas nenit 36 të Kodit Penal.